KALAJA E PRIZRENIT – NJË DËSHMI E TRASHËGIMISË ILIRO-DARDANE-SHQIPTARE



Prizren, 31 Korrik 2025

Këto ditë patëm mundësinë të ngjiteshim në këtë kodër simbolike, për të parë me sytë tanë një nga monumentet më të rëndësishme të pranisë iliro-dardane-shqiptare në Ballkan - Kalanw e Prizrenit.

Ajo nuk është thjesht një fortesë që ngrihet mbi një kodër të bukur me pamje drejt Lumbardhit, por një dëshmi ku historia e popullit tonë shfaqet hapur — një objekt rrëfyes që i ka mbijetuar shekujve, perandorive dhe shndërrimeve, pa humbur kurrë lidhjen e saj me thelbin më të thellë të identitetit shqiptar.

E vendosur në lindje të qytetit të Prizrenit, Kalaja qëndron si një qeleshe madhështore mbi kokën e këtij qyteti të lashtë shqiptar, duke soditur qetësisht rrjedhën e Lumbardhit dhe jetën përreth.

Gërmimet arkeologjike të zhvilluara midis viteve 2004 dhe 2011 kanë zbuluar dëshmi të një vendbanimi parahistorik, të datuar në epokën e bronzit dhe periudhën e hershme të hekurit. Këto të dhëna e bëjnë kalanë një nga pikëtakimet më të hershme të jetës qytetare në këtë trevë. Më tej, gjurmët e periudhës romake dhe të antikitetit të vonë dëshmojnë për

vazhdimësinë e kësaj pranie. Kalaja është, pa asnjë dyshim, një nyje e gjallë në hartën e qytetërimeve ilire, dardane dhe shqiptare.

Në formën e saj të njohur sot, kalaja mori tipare të qarta gjatë shekullit XI, nën ndikimin e Perandorisë Bizantine, për t'u shndërruar më vonë në rezidencë të përkohshme të car Stefan Dushanit, dhe më pas të përthithet nga Perandoria Osmane. Muret e saj mbartin shtresa nga të gjitha këto periudha, por në thelb ajo ka qenë gjithmonë fortesë e jetës shqiptare, simbol i qëndresës dhe mbrojtjes së Prizrenit.

Për më shumë se një mijëvjeçar, Kalaja ka shërbyer si pikë strategjike ushtarake, si vend komande dhe mbrojtjeje për rrugët tregtare që përshkonin Dardaninë. Në shekullin XIX, ajo humbi funksionin e saj ushtarak, por jo rolin në kujtesën kolektive. Në vitin 1878, kur shqiptarët u mblodhën për të themeluar Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Kalaja qëndronte aty lart, si një simbol i qartë i vazhdimësisë së tyre historike.

Kalaja është më shumë se një ndërtesë me vlera arkitektonike. Ajo është shkollë pa mësues, ku historia mësohet me heshtjen e gurëve. Nga lartësitë e saj, duket qartë qyteti i Prizrenit, që për shumë shekuj ka qenë qendër kulturore, ekonomike dhe politike e shqiptarëve në rajon.

Edhe pse në Prizren kanë bashkëjetuar etni të ndryshme si serbë, turq, boshnjakë dhe romë, Kalaja ka qenë dhe mbetet

në shërbim të realitetit shumicë shqiptare. Ajo ka qenë gjithmonë mburojë e popullsisë autoktone, vend stuhish por edhe qetësish, referencë e qëndrueshme në horizontin shpirtëror të këtij kombi.

Sot, Kalaja e Prizrenit është një monument i mbrojtur nga shteti i Kosovës. Pjesërisht e restauruar, ajo mirëpret vizitorë vendas e të huaj, me shtigje të pastruara dhe ndriçim që i jep jetë natën. Por ruajtja e saj afatgjatë, mbrojtja nga ndikimi urban dhe përfshirja në edukimin historik të brezave të rinj mbeten sfida thelbësore.

Kalaja e Prizrenit nuk është thjesht një atraksion turistik. Ajo është një kodër kujtese, një tempull i qëndresës, një monument i gjallë i trashëgimisë iliro-dardane-shqiptare. Përmes saj, ne nuk u themi të tjerëve se kush jemi – e lëmë atë ta bëjë këtë për ne, me dinjitet, me histori dhe me gurë që nuk heshtin.